

RELACION

PËR PROJEKTLIGJIN

PËR DISA NDRYSHIME NE LIGJIN NR. 55/2015 “PËR INVESTIMET STRATEGJIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN.

Qëllimi i projektligjit është miratimi i disa ndryshimeve në ligjin nr.55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Me anën e këtij ndryshimi synohet: të rritet në mënyrë të konsiderueshme vlera minimale e projekteve të investimit, të cilat aplikojnë për status strategjik në çdo sektor të klasifikuar strategjik sipas këtij ligji; të detajohet procedura e paraqitjes së dosjes së projektit dhe vlerësimit të saj duke përmirësuar afatet e shqyrtimit dhe duke theksuar përgjegjësisë që ka çdo ministri linje; si dhe të zgjatet afati i paraqitjes së kërkesave nga subjektet investuese të interesuara për përfshirjen në procedurat për përfitimin e statusit “Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë”, në zbatim të ligjit nr.55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, deri në datën 31 dhjetor 2027.

Theksohet se prej viti 2015 kur është miratuar ky ligj e deri sot janë miratuar 40 projekte investimi strategjik, që ende janë në proces zhvillimi, me një trend rritës për çdo vit, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik të vendit.

VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE.

Projektligji i mësipërm nuk është parashikuar në programin analitik për vitin 2024 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

II. ARGUMENTIMI I PROJEKTVENDIMIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME.

Me anën e këtij ndryshimi synohet të rritet në mënyrë të konsiderueshme vlera minimale e projekteve të investimit, të cilat aplikojnë për status strategjik në çdo sektor të klasifikuar strategjik sipas këtij ligji; të detajohet procedura e paraqitjes së dosjes së projektit dhe vlerësimit të saj duke përmirësuar afatet e shqyrtimit dhe duke theksuar përgjegjësitë që ka çdo ministri linje; si dhe të zgjatet afati i paraqitjes së kërkesave nga subjektet investuese të interesuara për përfshirjen në procedurat për përfitimin e statusit “Investim/ investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë”, në zbatim të ligjit nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, deri në datën 31 dhjetor 2027.

Paketa e plotë ligjore, ligj nr. 55/2015 dhe 10 VKM në zbatim të tij, e cila u hartua në vitin 2015, u konceptua si një paketë ligjore pilot, me qëllim që t’u jepte një nxitje të mtejshme projekteve të investimit në sektorët e cilësuar strategjikë sipas këtij ligji. Eksperienca dëshmoi se interesi i subjekteve ishte shumë i lartë për këtë paketë ligjore dhe masave mbështetëse që ajo ofron, ndaj nga viti 2018 e deri aktualisht kësaj pakete ligjore i është shtyrë afati i paraqitjes së aplikimeve të reja çdo vit. Nga ana tjetër, kjo paketë u ka shërbyer edhe vetë institucioneve të përfshira në vlerësimin e projekteve, pasi ndjekja e proceseve të investimeve tashmë gëzon një eksperiencë 6-vjeçare dhe në këta 6 vjet është krijuar një rrjet komunikimi mes institucioneve në nivel teknik dhe nivel vendimmarrës.

Nga viti 2016 e deri tani janë trajtuar 88 projekte investimi, prej të cilave:

- 40 kanë përfituar status strategjik
- 14 projekte janë refuzuar
- 34 projekte janë në fazë vlerësimi

Pjesa më e madhe e këtyre projekteve janë në sektorin e turizmit ose turizëm i integruar.

Duke qenë se interesi i subjekteve është ende shumë i lartë për të këtë paketë ligjore dhe fluksi dhe stoku i investimeve të huaja në vend janë në shifrat më të larta krahasuar me 10-vjeçarin e fundit, me qëllim shmangien e krijimit të këtij boshllëku ligjor, si dhe të pasojave që mund të krijohen prej tij, është menduar zgjatja e afatit të paraqitjes së kërkesave deri në datën 31 dhjetor 2027.

Për të siguruar që ligji thith investime madhore në sektorë strategjikë që arrijnë një zhvillim të rëndësishëm në fushën e tyre propozohet që në ligjin nr. 55/2015 të bëhen rishikimet e mëposhtme:

Sipas legjislacionit aktual, subjektet e interesuara mund të aplikojnë me projekte që fillojnë nga vlera 1 milion euro dhe të përfitojnë masat mbështetëse që legjislacioni parashikon. Aktualisht të gjithë sektorët janë të rregulluar me ligje të veçanta dhe ka ardhur koha të trajtohen me procedura të posaçme, nxitëse dhe favorizuese ato projekte që propozojnë vlera të konsiderueshme investimi, si dhe sjellin *brand*-in apo eksperiencën ndërkombëtare të standartit më të lartë, ndaj propozohet që vlera minimale e një projekti të propozuar për t'u kualifikuar si investim potencial strategjik të jetë mbi 50 milionë euro, në çdo sektor ose të krijojë minimalisht 300 vende pune. Njëkohësisht, nëse subjekti synon procedurën e veçantë, në çdo sektor, vlera e investimit të jetë e barabartë ose më e madhe se 100 milionë euro ose investimi të krijojë minimalisht 500 (pesëqind) vende të reja pune.

Njëkohësisht propozimi për ndryshime në ligj synon edhe rritjen e përgjegjshmërisë së vlerësimit të këtyre projekteve duke detajuar procedurën e vlerësimit, ndarjen e përgjegjësisë, si dhe në ndryshimet e ligjit përcaktohen dhe kushtet për monitorim kontrate/marrëveshje dhe shfuqizim statusi në rast mosplotësimi të kushteve të dakordësuara më parë.

Ligji nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 36 të tij ka përcaktuar se afati i fundit për paraqitjen e kërkesave nga subjektet investuese të interesuara për përfshirjen në procedurat për përfitimin e statusit “Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë”, në zbatim të këtij ligji është data 31 dhjetor 2023.

Projektligji i ri, me qëllim krijimin e vijimësisë pa shkëputje të pranimin të kërkesave për investime strategjike, parashikon që ky afat të shtrihet deri më 31 dhjetor 2027, duke i dhënë këssoj nenit 6 të këtij projektligji fuqi prapavepruese nga 1 janari 2024. Ky propozim është në përputhje me parimet kushtetuese.

Teoria e së drejtës pranon se fuqia prapavepruese zbatohet si përjashtim si për shembull në ligjet penale favorizuese, në ligjet që ndërhyjnë për të rregulluar me ligj situata të paligjshme të krijuara më parë, në ligjet që interpretojnë anët e errëta ose të paqarta të një ligji të mëparshëm e në ndonjë rast tjetër ku paraqitet domosdoshmëria për të shmangur pasoja të rënda, negative ose të pandreqshme.

Në rastin konkret, qëllimi i propozimit është shmangia e pasojave negative që lidhen me ndërprerjen e vijimësisë së ligjit e për rrjedhojë të aplikimeve të mundshme. Gjithashtu, theksoj se dhënia e fuqisë prapavepruese në rastin konkret nuk lidhet me dhënien e ndonjë lehtësie specifike aplikantit për investitor strategjik, kjo pasi që një investitor të marrë statusin e investitorit strategjik duhet të kalojë në një kalvar verifikimesh deri në marrjen e vendimit sipas ligjit për dhënien e statusit të investitorit strategjik. Vetëm pas marrjes së statusit investitori strategjik përfiton lehtësi dhe ndihmesë. Pra, fuqia prapavepruese nuk lidhet në mënyrë direkte me marrjen e një lehtësie fiskale apo administrative, për të rënë kështu ndesh me nenin 155 të Kushtetutës. Përkundrazi, projektligji është tërësisht në harmoni me parimin e sigurisë juridike duke krijuar kështu besim tek aplikuesit për vijimësinë e ligjit.

VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR.

Projektligji është në përputhje me nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Shqipërisë.

III. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTET NORMATIVE)

Nuk ka.

IV. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Në nenin 1 është parashikuar se neni 8, pika 3 “shfuqizohet” dhe zëvendësohet me:

3. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, investimet e propozuara për t’u konsideruar strategjike duhet të përmbushin respektivisht kriteret e përcaktuara si më poshtë:

a) për investitorët/projektet që do të përfitojnë statusin “Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar”, në çdo sektor të klasifikuar strategjik sipas këtij ligji, duhet të plotësohen kriteret më poshtë:

- i. vlera e investimit të jetë e barabartë ose më e madhe se 50 (pesëdhjetë) milionë euro; ose
 - ii. investimi krijon, minimalisht 300 (treqind) vende të reja pune; ose
 - iii. investimi synohet të realizohet në zona me prioritet zhvillimi;
- b) për investitorët/projektet që do të përfitojnë statusin “Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë”, në çdo sektor të klasifikuar strategjik sipas këtij ligji, duhet të plotësohen kriteret më poshtë:
- i. vlera e investimit të jetë e barabartë ose më e madhe se 100 (njëqind) milionë euro; ose
 - ii. investimi krijon minimalisht 500 (pesëqind) vende të reja pune.

Në nenin 1 është parashikuar gjithashtu që neni 8, pika 6 të “shfuqizohet”, pasi kjo pikë parashikon: *Statusin “Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë” e përfitojnë edhe investitorët/projektet investuese, për të cilat, pavarësisht se nuk janë parashikuar të realizohen në një nga sektorët e përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, parashikohet që vlerën totale të kapitalit investues të projektit ta kenë të barabartë ose më të madhe se 100 000 000 (njëqind milionë) euro.*

Me propozimet e reja në projektligj vlera prej 100 milionë eurosh është vlera minimale për të përfituar statusin Investim/investitor strategjik, procedurë e veçantë.

Në nenin 2 parashikohet shfuqizimi i nenit 13.

Në nenin 3 parashikohet ndryshimi i nenit 17 si më poshtë:

“Neni 17

Paraqitja e dosjes së projektit dhe shqyrtimi i saj

1. *Investitori potencial paraqet fillimisht pranë Agjencisë letrën e interesit për klasifikimin e projektit të investimit si investim strategjik, shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm mbi legjitimitimin e subjektit aplikues, ashtu si dhe me dokumentacionin teknik dhe hartografik, sipas legjislacionit në fuqi, të gjurmës ku synohet të realizohet investimi.*
 2. *Agjencia analizon paraprakisht profilin e investitorit si dhe realizon identifikimin kadastral të gjurmës ku synohet të realizohet investimi. Agjencia konsultohet dhe u kërkon mendim paraprak organeve të qeverisjes qendrore dhe vendore, të cilat administrojnë pronat e paluajtshme shtetërore si dhe u kërkon informacion vërtetues organeve shtetërore përkatëse.*
 3. *Në rast se pas identifikimit kadastral të gjurmës, projekti i investimit vlerësohet i mundshëm për tu realizuar, Agjencia këshillon subjektin e interesuar për vijimin e procedurave të mëtejshme dhe dorëzimin e projektit të plotë të investimit të shoqëruar me dokumentacionin e plotë mbështetës ligjor, teknik dhe financiar.*
-

4. Agjencia, nga data e dorëzimit të dokumentacionit të plotë nga ana e investitorit kryen të gjitha veprimet përgatitore, si dhe ofron shërbimet e nevojshme ndaj projektit potencial përfshirë shërbime analize, vlerësimi, koordinimi informacioni, të konsolidimit të tokës, si dhe shërbime përfaqësimi të investitorit tek institucionet/entet/autoritetet publike.

5. Pas përgatitjes së dokumentacionit të plotë nga ana e Agjencisë, projekti i investimit dorëzohet nga Agjencia tek ministria e linjës përgjegjëse për sektorin ku synohet investimi.

6. Ministria e linjës kryen brenda 20 ditësh vlerësimin e plotë të projektit të investimit dhe dokumentacionit shoqërues përgatitur nga Agjencia. Në përfundim të këtij vlerësimi, ministria e linjës harton raportin përfundimtar të shoqëruar me projekt vendimin me disa alternativa, bashkë me projekt kontratën e posaçme/marrëveshjen e investimit për zhvillimin e tij, për vendimmarrje të KIS.

7. KIS, bazuar në dokumentacionin e plotë, vendos për klasifikimin e investimit si investim strategjik dhe masat mbështetëse në masën dhe kushtet e parashikuara sipas këtij ligji.

8. Ministria përgjegjëse për sektorin në të cilin synohet investimi strategjik propozon për miratim pranë Këshillit të Ministrave projekt kontratën e posaçme/marrëveshjen e investimit.

9. KIS nëse pas monitorimit periodik të projektit të investimit për të cilin është ofruar mbështetje e posaçme, konstaton se ka mospërmbushje të detyrimeve të marra përsipër nga investitori pa shkak të arsyeshem, ose konstaton dhe vërteton se në projektin investues ka të dhëna të pavërteta apo ndryshim të të dhënave të dala rishtazi, mbi bazën e të cilave nuk do të ishte vendosur dhënia e statusit ka të drejtë:

a) të pezullojë çdo veprim nga ana e institucioneve të administratës të përfshira në dhënien e masave mbështetëse, deri në momentin e plotësimin të detyrimeve të paplotësuara nga investitori; ose

b) ta shfuqizojë vendimin, duke vendosur edhe penalitete në rast të dëmit të shkaktuar.

10. Procedura e detajuar mbi vlerësimin dhe afatet për dhënien e statusit, monitorimin e kontratave apo marrëveshjeve me investitorin, prishjen e objekteve në gjurmë të projektit dhe procedura për disponimin me pronë publike, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Në nenin 4 parashikohet shfuqizimi i nenit 19, pasi përfshihet në nenin 17 sipas ndryshimeve të parashikuara më lart.

Në nenin 5 parashikohet ndryshimi edhe i nenit 20 kjo për shkak të ndryshimeve të reflektuara në nenet 13, 17 dhe 19. Neni 20 sugjerohet të riformulohet me këtë përmbajtje:

“Neni 20

Detyrimet e investitorit pas pezullimit dhe/ose shfuqizimit të vendimit për dhënien e statusit

- 1. Zbatimi i sanksioneve administrative të përcaktuara në pikën 9 të nenit 17, nuk e liron investitorin nga përgjegësia civile për dëmin e shkaktuar, sipas legjislacionit në fuqi.*
- 2. Në rast të shfuqizimit të vendimit për dhënien e statusit sipas në pikën 9 të nenit 17 të ligjit, ministri përgjegjës i fushës përkatëse ndërmerr veprimet e nevojshme ligjore për rregullimin e pasojave, sipas legjislacionit në fuqi.*

Në nenin 6 është përcaktuar se në nenin 36 të ligjit nr.55/2015, fjalët “data 31 dhjetor 2023” zëvendësohen me fjalët “data 31 dhjetor 2027”.

Në nenin 7 është përcaktuar formula e hyrjes në fuqi të këtij ligji duke përcaktuar se ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare me përjashtim të nenit 6 të këtij ligji, i cili i shtrin efektet nga 1 janari 2024.

V. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ AKTI.

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen AIDA, Komiteti i Investimeve Strategjike, si dhe të gjitha institucionet/entet dhe organet e administratës shtetërore.

VI. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT.

Projektligji është nismë deputeti.

VII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE.

Miratimi i projektligjit të propozuar nuk kërkon fonde shtesë.

-

